



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

KONFERENCA E KRYETARËVE

VENDIM

Nr. 18, datë 30.10.2018

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT TË KUVENDIT PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË RAPORTIT TË DYTË TË PËRPUTHSHMËRISË, LIDHUR ME RAUNDIN E KATËRT TË VLERËSIMIT TË GRECOS PËR SHQIPËRINË

Në mbështetje të nenit 12 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, me propozim të Kryetarit të Kuvendit,

KONFERENCA E KRYETARËVE

VENDOSI:

- I. Miratohet Plani i Veprimit të Kuvendit për zbatimin e rekomandimeve të Raportit të Dytë të Përputhshmërisë, lidhur me Raundin e Katërt të Vlerësimit të GRECO-s për Shqipërinë, sipas dokumentit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
- II. Ngarkohen organet e Kuvendit, deputetët dhe strukturat përgjegjëse në Kuvend për zbatimin në kohë dhe me cilësi të masave të parashikuara në këtë Plan Veprimi.
- III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit t'i dërgojë raportim Ministrisë së Drejtësisë dhe GRECO-s, për ecurinë e zbatimit të masave të parashikuara në Planin e Veprimit, sipas afateve të kërkuara.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Gramoz Ruci



**PLANI I VEPRIMIT TË KUVENDIT PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE
TË RAPORTIT TË DYTË TË PËRPUTHSHMËRISË,
LIDHUR ME RAUNDIN E KATËRT TË VLERËSIMIT TË GRECO-s PËR SHQIPËRINË¹**

REKOMANDIMET E GRECO-s	MASAT	AFATI	STRUKTURA PËRGJEGJËSE PËR ZBATIMIN E TYRE	STATUSI I REALIZIMIT TË MASAVE
Rekomandimi ii. 15. <i>GRECO</i> <i>rekomandoi që</i> <i>i) Kodi i Sjelljes për</i> <i>deputetët, të</i> <i>parashikuara në</i> <i>Rregulloren e</i> <i>Procedurës së</i> <i>Asamblesë</i> <i>Kombëtare, të</i> <i>përpunohet dhe të</i> <i>zbatohet siç duhet;</i> <i>dhe</i> <i>ii) trajnimi, udhëzimi</i> <i>dhe këshillimi të</i> <i>vihen në dispozicion</i> <i>të deputetëve për</i> <i>çështje të tilla si</i> <i>forma, mënyra dhe</i> <i>objekti i kontakteve të</i> <i>lejueshme me grupet</i> <i>e interesit dhe</i>	1. Hartimi dhe miratimi i draftit të udhëzuesit të detajuar për zbatimin e Kodit të Sjelljes së Deputetëve.	Tetor 2018	Sekretari i Përgjithshëm Byroja e Kuvendit	
	2. Hartimi dhe miratimi i ndryshimeve në Rregulloren e Kuvendit, duke parashikuar se masat disiplinore që parashikon Rregullorja e Kuvendit për shkeljen e saj, zbatohen edhe në rastet e shkeljes së Kodit të sjelljes së Deputetëve dhe Udhëzuesit të Detajuar për zbatimin e tij.	Dhjetor 2018	Kuvendi në Seancë Plenare Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin Komisioni i Ligjeve Administrata e Kuvendit	
	3. Sesione informimi për Kodin e Sjelljes dhe Udhëzuesin në zbatim të tij për 140 deputetë.	Tetor - 15 nëntor 2018	Deputetët Sekretari i Përgjithshëm Shërbimi i Burimeve Njerëzore dhe Trajtimit të	

¹ Miratuar me vendimin nr. 18, datë 30.10.2018 të Konferencës së Kryetarëve

lobistët, zbulimi i konflikteve ad hoc të interesit, etikës dhe parandalimit të korrupsionit brenda radhëve të tyre.	3. 1. Simpozium për konfliktin e interesit dhe deklarimin e pasurive, organizuar nga Kuvendi dhe ILDKPI.	Nëntor 2018	Deputetëve Ekspertë nga ILDKPKI Ekspertë të huaj	
	4. Shpërndarja në rrugë elektronike dhe në <i>hard copy</i> në dispozicion të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kodit të Sjelljes dhe Udhëzuesit për zbatimin e Kodit të Sjelljes.	Tetor 2018	Shërbimi i Burimeve Njerëzore dhe Trajtimit të Deputetëve	
	5. Thirrje publike për akreditimin e lobistëve, grupeve të interesit dhe organizatave të shoqërisë civile që bashkëpunojnë me Kuvendin	Tetor – nëntor 2018	Shërbimi i Komisioneve/ specialisti për koordinimin e grupeve të interesit/Shërbimi i IT-së.	
	6. Krijimin e regjistrit të lobimit, grupeve të interesit dhe shoqërisë civile dhe përditësimi i tij në vazhdimësi	Nëntor 2018 – në vazhdim	Shërbimi i Komisioneve	
	7. Krijimi i regjistrit të veçantë elektronik për dhuratat dhe publikimi i tij në faqen e internetit të Kuvendit.	Tetor dhe në vazhdim	Shërbimi i Burimeve Njerëzore dhe Trajtimi të Deputetëve/Shërbimi i IT-së	

	8. Krijimi i një vendi të përshtatshëm për ekspozimin dhe ruajtjen e dhuratave të deputetëve 9. Ngritja e një komisioni për caktimin e vlerës së dhuratës	Dhjetor dhe në vazhdim Nëntor 2018	Shërbimi Administrativ Sekretari i Përgjithshëm Shërbimi Administrativ	
Rekomandimi iii. <i>GRECO rekomandoi që të krijohet një mekanizëm për njoftimin "rast pas rasti" për konfliktet e interesit nga ana e deputetëve në Kuvend dhe që operacioni i këtij mekanizmi t'i nënshtrohet monitorimit.</i>	1. Pajisja e sekretariatit të komisioneve të përhershme dhe e seancës plenare me formularin e deklaratës së konfliktit të interesit rast pas rasti për aktet individuale që shqyrtohen dhe miratohen (propozimet/projektvendimet). 1.1. Plotësimi nga çdo deputet i deklaratës së konfliktit të interesit rast pas rasti, në rast se janë në konflikt interesi, para votimit në komisione dhe seancë plenare si dhe administrimi i tyre në shërbimin përkatës. 1.2. Publikimi i formularit të deklarimit të konfliktit të interesit të plotësuar në faqen zyrtare të internetit në Kuvend 1.3. Informimi i deputetëve për përmbushjen e detyrimit të	Tetor 2018 dhe në vazhdim Tetor 2018 dhe në vazhdim Tetor 2018 dhe në vazhdim Nëntor 2018 dhe në vazhdim	Shërbimi i Komisioneve/ Shërbimi i seancës plenare. Shërbimi i Burimeve Njerëzore dhe Trajtimi të Deputetëve/Shërbimi I IT Shërbimi i Burimeve Njerëzore dhe Trajtimi të Deputetëve/Shërbimi i IT - Shërbimi i Komisioneve/ - Shërbimi i seancës	

	parashikuar në Kodin e Sjelljes dhe Udhëzuesin në zbatim të tij për deklarimin e konfliktit të interesit rast pas rasti. 2.Krijimi i regjistrit të konfliktit të interesit dhe publikimi në faqen e internetit.	20 Dhjetor 2018	plenare - Shërbimi i Burimeve Njerëzore dhe Trajtimi të Deputetëve. Shërbimi i Burimeve Njerëzore dhe Trajtimi të Deputetëve/Shërbimi i IT	
--	---	-----------------	--	--